



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË
MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI
“MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMI
FINANCIAR
NË
MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE,
PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”**

NËNTOR 2023



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. KONKLuzioni I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	3
II. HYRJA	5
1. Titulli	5
2. Marrësi.....	5
3. Objektivat dhe qëllimi	5
4. Identifikimi i çështjes:	6
5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:	6
6. Përgjegjësitë e audituesve.....	6
7. Kriteret e vlerësimit	6
8. Standardet e auditimit.....	7
9. Metodatat e auditimit.....	8
10. Dokumentimi i auditimit	8
II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM	9
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	10
III. KONKLuzioni I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	38



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), zyrën e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (PMU), Projektin ‘Modernizimi i Asistencës Sociale’ në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 782/1 prot, datë 02.10.2023, me afat auditimi nga data 02.10.2023 deri me datë 31.10.2023, për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022. Konkretisht u audituan raportimi i PMU në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për shumata e alokuara, raportimet e aktivitetit vjetor Plan – Fakt, evidencat statistikore të dërguara nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) dhe Drejtoritë e Shërbimit Social (DSHSSH) pjesë e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Për gjetjet e konstatuara është mbajtur 1 akt, i dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social (DPSHSSH).

2. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të auditimit të raporteve financiare të dorëzuara nga ana e Bankës Botërore të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **Opinion të pakualifikuar**¹, pasi raportet paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale në fund të periudhës ushtrimore në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik. Në drejtim të Raportimit nga ana e PMU tek Donatori (Banka Botërore), vlerat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror u konstatua se në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e financimit, PMU ka raportuar mbi fondet e alokuara në fillim të vitit për programin e NE nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Për vitin 2022 nuk u konstatuan diferenca materiale.

Opinion i pakualifikuar për pasqyrat financiare

Ne audituam raportet financiare të subjektit PMU për projektin “Modernizimi i Asistencës Sociale”, për vitin 2022, të cilat përmbajnë raportin e gjeneruar nga Sistemi i Thesarit për çeljen e fondeve për programin e ndihmës ekonomike. Në opinionin tonë, raportimi financiar është kryer mbi bazën e kuadrin raportues sipas përcaktimeve të bëra në marrëveshjet e financimit Ligjit 84/2012 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 53/2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale” dhe paraqesin drejtë situatën financiare.

¹ **Opinion i pakualifikuar.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të pakualifikuar kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar.



Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI's). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.

Përgjegjësitë e drejtuesve të MSHMS

Drejtoria e Financës pranë MSHMS;

Struktura e PMU brenda MSHMB, përgjegjëse për menaxhimin e Projektit objekt auditimi;

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror;

Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

Drejtoritë e Shërbimit Social pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV);

Strukturat e mësipërme janë përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik, për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare si dhe për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve Shtetëror të KLSH.

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar, të: - vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000 dhe 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar.

Ne, si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 782/1 prot, datë 02.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 02.10.2023 deri më datë 31.10.2023, në subjektin “*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Projekti ‘Modernizimi i Asistencës Sociale’*”, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u krye “*Auditim Financiar*” me përbërje:

I. S., Përgjegjës Grupi,
I.B., Audituese

1. Titulli

Raport Përfundimtar mbi auditimin financiar në “*Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Projekti ‘Modernizimi i Asistencës Sociale’*”.

2. Marrësi

“*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”, me përfaqësues zj. A.K., Ministër.

3. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi i përgjithshëm është shprehja e një opinionit me një siguri të arsyeshme nga ana e audituesve nëse transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 si dhe nëse janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Për auditimin Financiar, qëllimi i tij është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare të Projektit për periudhën 2022.

Auditimi financiar do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), dhe standardet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një anëtar i INTOSAI-t.

Këto standarde kërkojnë që auditori të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të testit, të provave që mbështesin shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive të auditimit në lidhje me shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare nga secili prej entiteteve, në mënyrë që të hartojë procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethana, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

4. Identifikimi i çështjes:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (DPSHSSH), Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) dhe Drejtoritë e Shërbimit Social në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (DSHSNJVV) duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të punimeve/shërbimeve të ofruara nga Projekti.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

- Drejtoria e Financës pranë MSHMS;
- Struktura e PMU brenda MSHMB, përgjegjëse për menaxhimin e Projektit objekt auditimi;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror;
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- Drejtoritë e Shërbimit Social pranë Njësite të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV);

Strukturat e mësipërme janë përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik, për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare si dhe për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmimeve të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në llogaritë e transaksioneve financiare dhe shpenzimeve përkatëse. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të keq deklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura, si dhe të arsyeshmërisë së vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Gjatë kryerjes së procedurës për vlerësimin e rrezikut, audituesit marrin parasysh kontrollin e brendshëm përkatës në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit lidhur me efektshmërinë e tij. Sidoqoftë, audituesit do të komunikojnë me shkrim për ndonjë mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që është relevante me auditimin e pasqyrave financiare të cilat i identifikohen gjatë auditimit.

7. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, ISSAI 300 “Standardet e Fushës së Auditimit Shtetëror”, ISSAI 400 “Standardet e Raportimit në Auditimin Shtetëror”, ISSAI 1000 – 2999 “Udhëzues i Auditimit Financiar”.

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 84/2012 datë 18.09.2012 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

Ligji nr. 53/2018 datë 23.07.2018 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale”.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 8379, dt. 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse;

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

Ligji nr. 9355, datë 10/03/2005 “ Për ndihmën dhe shërbimin shoqëror”, të ndryshuar;

VKM nr. 904, datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot” me ndryshimet;

VKM nr. 787, datë 14/02/2005 “Për përcaktimin e kriterëve e procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”;

VKM nr. 452, datë 01.07.1998 “Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj”;

VKM nr. 775, datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”;

VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”.

VKM nr. 452, datë 01.07.1998 “Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj”;

Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;

Rregullore “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 63, datë 22.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar.

Manuali i Auditimit Financiar miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 64 datë 22.06.2020.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;

Udhëzim i MF nr. 8, datë 17.02.2003 “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”;

Udhëzimin e MF nr. 20, datë 24.12.2003 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësive të menaxhimit, zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”;

Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e Njësive të Menaxhimit të Projekteve; të tjera.

8. Standardet e auditimit

-Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

ISSAI (100) “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI (200) “Parimet themelore të auditimit financiar” që përcakton parime themelore **ISSAI (100)** dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit financiar;

ISSAI (1000 - 2999) “Udhëzimet për auditimin financiar”;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t,
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin Financiar”; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;

9. Metodatat e auditimit

- Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek risku dhe kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyrë të përgjithshme, u bënë teste në ushtrimin e auditimit për saktësinë e raportimit të aktivitetit ekonomik.
- Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.
- Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj. Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{se} nr. 64, datë 22.06.2020 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Marrëveshjet e Financimit: Në total për financimin e Projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale”, janë lidhur me donatorin *Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)* dy marrëveshje;

- 1-** Marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 84/2012 ‘*Për ratifikimin e Marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale*’, i ndryshuar;
- 2-** Marrëveshja e ratifikuar me ligjin nr. 53/2018 ‘*Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale*’, i ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike për vitin 2022, nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri. Në lidhje me këtë pikë u morën të dhënat e raportuara nga PMU në IBRD për shumata e alokuara, raportimet e aktivitetit vjetor Plan – Fakt të DPSHSSH për vitet 2022, evidencat statistikore të dërguara nga DRSHSSH dhe DSHSNJVV për vitet 2022 dhe u bënë kryqëzimet e nevojshme të të dhënave të marra nga Raportimet e bëra nga DPSHSSH në MFE si dhe të dhënat e marra nga Raportimet e kryera nga Drejtoritë e Shërbimit Social pranë Bashkive.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Projekti “*Modernizimi i Asistencës Sociale*” është një projekt i iniciuar në vitin 2012 ku sipas PAD – it përkatës të miratuar me datë 17.02.2012 nga ana e Bankës Botërore (*Project Appraisal Document/Dokumenti i Vlerësimit të Projektit*) ky Projekt ka si objektiv mbështetjen e zbatimit të reformave të Qeverisë për të përmirësuar barazinë dhe efikasitetin e programeve të saj të asistencës sociale. Projekti synon të nxisë gjithashtu parimin e transparencës ndërsektoriale për të mbështetur këto objektiva duke patur si qëllim të kontribuojë në reduktimin e varfërisë dhe cënueshmërisë përmes shërbimeve më efektive të asistencës sociale.

Projekti ka parashikuar të arrijë objektivin e tij nëpërmjet zbatimit të dy komponentëve të mëposhtëm:

- *Forcimi i Zbatimit dhe Performancës së Programeve të Asistencës Sociale;*

Objektivi i këtij komponenti është mbështetja e rezultateve nga përmirësimet në programet kryesore të asistencës sociale. Ky komponent do të mbështesë përmirësimin e implementimit si tek programi Ndihmës Ekonomike (NE) dhe PAK ashtu edhe përfitimet e asistencës së aftësive të kufizuara në fushat kryesore të identifikuar në hartën e gjerë të reformave:

- *Asistenca Teknike për të Forcuar Kapacitetin për Zbatimin e Programeve të Asistencës Sociale.*

Objektivat e këtij komponenti janë forcimi i kapaciteteve për përmirësimin e implementimin në përfitimet e ofrimit të asistencës sociale. Ky komponent do të financojë aktivitete të përzgjedhura të asistencës teknike dhe investimeve.

Njësia Menaxhere e Projektit (PMU) e ngritur pranë MSHMS është struktura përgjegjëse për implementimin e Projektit. Kjo njësi është përgjegjëse për menaxhimin e rregullt të Projektit si dhe për koordinimin e nevojshëm me IBRD. Auditimi financiar nga ana e KLSH është kryer mes të tjerave dhe në bazë të detyrimeve që lindin nga Ligji nr. 53/2018 ‘*Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Shtesën e Financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale*’, i ndryshuar, Skeduli 2 Zbatimi i Projektit, Seksioni 1 Zbatimi, Germa A *Kuadri Raportues* si dhe parashikimeve të bëra nga Manualin Operacional të Projektit (POM), kapitulli VII. Menaxhimi Financiar.

Në kuadër të sa më sipër është bërë Auditimi Financiar për vitet 2022, fushëveprimi dhe objektivi i të cilit ishte Komponenti 1, Ndihma Ekonomike dhe dhënia e opinionëve për llogaritë e transaksioneve financiare dhe shpenzimeve për vitin 2022. Konkretisht, grupi i auditimit auditoi akt rakordimet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Raportet e aktivitetit vjetor të DPSHSSH, çeljet e buxhetit për 61 NJVV dhe rialokimet përkatëse, evidencat statistikore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

përmbledhëse të DPSHSSH, raportimet dy mujore të kryera nga 12 DRSHSSH dhe 61 NJVV, urdhër-shpenzimet përkatëse për 2 muaj të vitit 2022.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

Në zbatim të pikës së Programit të Auditimit nr. 782/1 prot, datë 02.10.2023, “Mbi vlerësimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për vitin 2022, nëse janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të aplikueshëm në Shqipëri”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Evidencat Statistikore të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror;
- 2- Evidencat statistikore të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social;
- 3- Raportet e aktivitetit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror;
- 4- Rakordimet e bëra midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Thesarit;
- 5- Rakordimet mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

Për sa i përket NE kjo është parashikuar të shpërndahet sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfutimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar me Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 85, datë 10.02.2021

Sipas nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së shpërblimit të ndihmës ekonomike”, 5 kategoritë përfituese të kësaj ndihme ekonomike janë:

- 1) familjet në nevojë (familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme);
- 2) jetimët të cilët nuk janë në institucione;
- 3) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- 4) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- 5) viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes ose të urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Hapat që ndjek procedura e marrjes së NE është si më poshtë:

Identifikimi

- Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme:
 - a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij dhe përmbledh informacionin për:
 - i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;
 - ii) llojin e banesës;
 - iii) pasuritë/asetet familjare;
 - iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.
- Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën socialekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që përfitojnë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2;

- Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshorten, kur ka një të tillë, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën, sipas shtojcës 3, që është pjesë përbërëse e vendimit të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe që plotësohet çdo 3 (tre) muaj;
- Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki përgatit projektvendimin për familjet/individët që kërkojnë të trajtohen me ndihmë ekonomike, në bazë të të dhënave të gjeneruara nga administratori shoqëror dhe e paraqet për miratim pranë Këshillit Bashkiak, i cili brenda datës 20 të çdo muaji merr vendimin për propozim për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe ia përcjell Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas ardhjes së vendimit për propozim nga Këshilli Bashkiak, verifikon të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë, gjeneron vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, përkatësisht:
 - a) Për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe masën e përfitimit të tyre;
 - b) Për familjet/individët jopërfitues me arsyen përkatëse të refuzimit.
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, i dërgon Kryetarit të Bashkisë vendimin:
 - a) për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;
 - b) për të kryer veprimet financiare, për kryerjen e pagesës, për përfituesit e ndihmës ekonomike;
- Pagesat e ndihmës ekonomike paguhen nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njërive administrative ku ka vendbanimin përfituesi ku Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/komisionohen;

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare si dhe pajtueshmërinë me kornizën raportuese.

Projekti SAMP përfshin komponentë me mekanizëm të ndryshëm financimi, po ashtu dhe qasja e kontabiliteti ndryshon sipas komponentëve.

Njësia e Menaxhimit të Projektit në MMSR, është përgjegjëse për aspektet e implementimit të aktiviteteve të parashikuara nën këtë Projekt e ndjek procedurat tradicionale të Bankës Botërore dhe kuadrit ligjor kombëtar lidhur me implementimin e projekteve me financim të huaj.

Këto procedura zbatohen vetëm **për Komponentin 2 të Projektit** dhe përfshijnë përdorimin e pasqyrave tradicionale të shpenzimeve dhe procedurat e disbursimit nëpërmjet një Llogarie të Projektit në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në Llogarinë Speciale në Bankat e nivelit të dytë. Procedurat e disbursimit të fondeve dhe menaxhimit financiar janë përcaktuar dhe në Manualin Operacional të Projektit.

Pasqyrat Financiare të Projektit për vitin 2022 përfshijnë sa më poshtë:

A. Raporti Menaxhimit të Projektit.

B. Raportet Financiare:

Burimet e Projektit dhe Përdorimi i Fondeve – Fondet e Donatorit IBRD,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

*Përdorimi i Fondeve sipas Komponentëve/Aktivitetëve të Projektit- Fondet e Donatorit
IBRD,*

Pasqyrën e Llogarisë Speciale,

C. Raporti i Progresit të Projektit:

Raport i Monitorimit të Rezultatit

D. Raporti menaxhimit të Prokurimeve:

Monitorimi Procesit të Prokurimit (Mallrat)

Monitorimi Procesit të Prokurimit (Shërbime konsulence)

Raport i Shpenzimeve të kontratave (Mallra)

Raport i Shpenzimeve të kontratave (Shërbime konsulence)

E. Raporti financiar gjeneruar nga sistemi i thesarit:

Sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i thesarit ekzekutimi i fondeve publike për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar për periudhën janar dhjetor 2022 është si më poshtë:

1. Ndihma ekonomike.

Accrual = 6,663,410.72 mijë lekë.

Cash = 5,949,097.63 mijë lekë.

Në vijim Ministria e Financave ka dërguar në mënyrë periodike tremujore raportet financiare të gjeneruara nga sistemi i thesarit. Bazuar në këtë informacion është përgatitur dhe Raporti Financiar për komponentin 1 të projektit i cili është paraqitur më pas zyrtarisht në Bankën Botërore.

Tabela nr. 1: Diferenca në raportim midis BB dhe SHS në vlerat e buxhetit të alokuara
në lekë

Kodi i artikullit	Institucioni		Raportimi te Banka 01 January- 31 December 2022	Celjet sipas SHS	Diferenca
	Bashkia				
2101001	Tirane	3535	281,738,000	281,738,000	-
2102001	Berat	0202	55,126,000	55,126,000	-
2103001	Bulqize	0603	228,253,000	228,253,000	-
2104001	Delvine	3704	16,252,000	16,252,000	-
2105001	Devoll	1505	115,990,000	115,990,000	-
2106001	Diber	0606	649,301,000	649,301,000	-
2107001	Durres	0707	27,845,000	27,845,000	-
2108001	Shijak	0707	9,143,000	9,143,000	-
2109001	Elbasan	0808	506,669,000	506,669,000	-
2110001	Cerrik	0808	70,839,000	70,839,000	-
2111001	Fier	0909	76,910,000	76,910,000	-
2112001	Patos	0909	21,353,000	21,353,000	-
2113001	Roskovec	0909	25,182,000	25,182,000	-
2114001	Gramsh	0810	193,778,000	193,778,000	-
2115001	Gjirokaster	1111	14,067,000	14,067,000	-
2116001	Libohove	1111	1,208,000	1,208,000	-
2117001	Has	1812	238,370,000	238,370,000	-
2118001	Kavaje	3513	34,410,000	34,410,000	-
2119001	Rrogozhine	3513	30,100,000	30,100,000	-
2120001	Kolonje	1514	26,240,000	26,240,000	-
2122001	Korce	1514	75,475,000	75,475,000	-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PROJEKTI “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

2123001	Kruje	0716	60,819,000	60,819,000	-
2124001	Kucove	0217	15,247,000	15,247,000	-
2125001	Kukes	1818	585,651,000	585,651,000	-
2126001	Kurbini	2019	118,025,000	118,025,000	-
2127001	Lezhe	2020	112,804,000	112,804,000	-
2128001	Librazhd	0821	284,414,000	284,414,000	-
2129001	Lushnje	0922	46,758,000	46,758,000	-
2130001	Malesi e Madhe	3323	83,737,000	83,737,000	-
2131001	Mallakaster	0924	66,511,000	66,511,000	-
2132001	Mat	0625	184,295,000	184,295,000	-
2133001	Mirdite	2026	95,144,000	95,144,000	-
2134001	Peqin	0827	159,858,000	159,858,000	-
2135001	Permet	1128	7,893,000	7,893,000	-
2136001	Pogradec	1529	428,190,000	428,190,000	-
2137001	Puke	3330	36,276,000	36,276,000	-
2138001	Sarande	3731	25,084,000	25,084,000	-
2139001	Skrapar	0232	41,651,000	41,651,000	-
2140001	Polican	0232	21,949,000	21,949,000	-
2141001	Shkoder	3333	191,972,000	191,972,000	-
2142001	Tepelene	1134	23,403,000	23,403,000	-
2143001	Memaliaj	1134	38,459,000	38,459,000	-
2145001	Tropoje	1836	187,338,000	187,338,000	-
2146001	Vlore	3737	64,901,000	64,901,000	-
2147001	Divjake	0922	26,516,000	26,516,000	-
2152001	Belsh	0808	70,884,000	70,884,000	-
2153001	Prrenjas	0821	255,784,000	255,784,000	-
2154001	Kelcyre	1128	19,005,000	19,005,000	-
2155001	Fushe - Arrez	3330	41,202,000	41,202,000	-
2156001	Konispol	3731	9,553,000	9,553,000	-
2157001	Vau i Dejes	3333	120,798,000	120,798,000	-
2159001	Selenice	3737	37,598,000	37,598,000	-
2160001	Himare	3737	7,767,000	7,767,000	-
2165001	Vore	3535	9,683,000	9,683,000	-
2166001	Kamez	3535	74,986,000	74,986,000	-
2167001	Ura Vajgurore	0202	17,427,000	17,427,000	-
2168001	Maliq	1515	259,495,000	259,495,000	-
2326001	Finiq	3704	3,950,000	3,950,000	-
2452001	Dropull	1111	2,147,000	2,147,000	-
2499001	Pustec	1515	5,806,000	5,806,000	-
2654001	Klos	0625	172,006,000	172,006,000	-
	Totali		6,713,235,000	6,713,235,000	-

Burimi: SHS

Grupi i auditimit bazuar në analizë e riskut dhe materialitetit ka evidentuar që raportimi i kryer tek Banka Botërore ka vlerat e buxhetuara (çelura) për vitin 2022 për 61 njësi bashkiake dhe realizimin përkatës.

Po krahasojmë vlerat e buxhetuara për 61 njësitë bashkiake dhe rezulton se nuk ka një mospërputhje të vlerave.

Raportimi për shpenzimin për programin e NE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

